

Gjuhësi kontrastive

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	Gjuhësi kontrastive
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	viti i IV-të, semestri i VII-të
Numri i orëve në javë:	2 + 0
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. Asoc. Dr. Vjosa Hamiti
Të dhënat kontaktuese:	vjosa.hamiti@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda <i>Gjuhësi kontrastive</i> u prezanton studentëve konceptet bazë dhe zhvillimet historike të kësaj disipline, e cila merret me studimin dhe përshkrimin e ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet gjuhëve të ndryshme (perspektiva interlinguale), si dhe me variacionet brenda një gjuhe të vetme (perspektiva intralinguale), për shembull gjermanishtja standarde në Gjermani, Austri dhe Zvicër.</p> <p>Në fillimet e saj, gjuhësia kontrastive u përqendrua kryesisht në krahasimin e strukturave morfosintaksore dhe leksikore, duke synuar lehtësimin e procesit të mësimdhënies së gjuhëve të huaja dhe hartimin e materialeve mësimore. Në fazat më të reja, fusha është zgjeruar duke përfshirë analiza tekstuale, diskursive dhe sociolinguistike, të cilat japin një pamje më të plotë të përdorimit të gjuhës në kontekste të ndryshme.</p> <p>Lënda synon të pajisë studentët me njohuri mbi teoritë dhe metodat e gjuhësisë kontrastive, duke i udhëzuar ata të aplikojnë këto qasje në analiza konkrete gjuhësore. Studentët do të njihen me fazat e zhvillimit të kësaj fushe, me problematikat kryesore që dalin nga krahasimet ndërgjuhësore, si dhe me rëndësinë praktike të gjuhësisë kontrastive në</p>

	mësimdhënien e gjuhëve të huaja, përkthim dhe studime ndërkulturore.
Qëllimet e lëndës:	Kjo lëndë synon që: <ul style="list-style-type: none"> t'u prezantojë studentëve nocionet themelore dhe konceptet kryesore të gjuhësisë kontrastive; t'i pajisë ata me njohuri mbi metodat dhe qasjet e analizës gjuhësore kontrastive; t'i udhëzojë studentët në shqyrtimin dhe krahasimin e dukurive gjuhësore të shqipes dhe gjermanishtes, duke zbatuar metodat e gjuhësisë kontrastive.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> shpjegojnë nocionet themelore dhe rolin e gjuhësisë kontrastive; zbatojnë metodat kryesore të analizës kontrastive në shqipe dhe gjermanishte; analizojnë dhe krahasojnë dukuri morfosintaksore dhe leksikore të dy gjuhëve; vlerësojnë rëndësinë praktike të gjuhësisë kontrastive në mësimdhënie dhe përkthim.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.30
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	2	2	4
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final			

Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	30 min	1	0.5
Total			85.5 : 25=3,432 3 ECTS

Metodat e mësimdhënies: Metodologjia e mësimdhënies: Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike, ushtrimeve ku krahasohen aspekte të ndryshme të gjermanishtes dhe shqipes, përgatitjes dhe prezantimit të punimeve seminarike.

Metodat e vlerësimit: Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 55%.
Vijueshmëria e studentit 10%;
Prezantimi I projektit në klasë 40%;
Punimi seminarik (Provimi final) 50%.

Literatura primare:

1. Rein, Kurt (1983): Einführung in die kontrastive Linguistik. Darmstadt: Wissenschaftliche Buchgesellschaft.
2. Gnutzmann, Claus (1990): Kontrastive Linguistik. Frankfurt a.M. u.a.: Lang
3. Wildenauer-Józsa, Doris (2005): Sprachvergleich als Lernstrategie. Eine Interviewstudie mit erwachsenen Deutschlernenden. Freiburg im Breisgau: Fillibach.
4. Linke, Angelika/Markus Nussbaumer/Paul R. Portmann (2004): Studienbuch Linguistik. 5. Aufl. Tübingen. (Reihe Germanistische Linguistik 121.)

Literatura shtesë:

1. Kocsany, P. (2010): Grundkurs Linguistik, UBT, W. Fink Verlag, Paderborn;
2. Busch, A./ Stenschke, O. (2007): Germanistische Linguistik, Narr:Tübingen
3. Putzer, O. (1994): Fehleranalyse und Sprachvergleich, Hueber Verlag, Ismaning
4. Heringer, Hans Jürgen (2004): Interkulturelle Kommunikation. Tübingen: Francke

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Einführung in die Lehrveranstaltung
Java 2:	Gegenstand und Definitionen der Kontrastiven Linguistik. Zur Stellung der Kontrastiven Linguistik.

Java 3:	Zwei Aspekte e Komparabilität impliziert zwei Aspekte a) Objektsprachlichen b) Metasprachlichen (die Komparabilität der Beschreibungen)
Java 4:	Bisherige Entwicklung Kontrastiver Aspekt in der neueren Sprachwissenschaft. Kritik an der kontrastiven Linguistik.
Java 5:	Ziele und Aufgaben der kontrastiven Linguistik heute.
Java 6:	Tertium comparationis.
Java 7:	Kontrastieren von Sprachen (Invarianz, Äquivalenz, Adäquatheit)
Java 8:	Methodische Grundannahmen.
Java 9:	Kontrastive Phonologie. Kontrastive Morphologie. Kontrastive Syntax.
Java 10:	Kontrastive Lexikologie und kontrastive Phraseologie.
Java 11:	Seminararbeit Präsentation
Java 12:	Seminararbeit Präsentation
Java 13:	Seminararbeit Präsentation
Java 14:	Seminararbeit Präsentation
Java 15:	Abgabe der Seminararbeit

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet rregullisht. Lejohen maksimumi **tri mungesa gjatë semestrit**; tejkalimi i këtij kufiri ndikon në pjesëmarrjen dhe vlerësimin final. Detyrat që dalin nga orët e mësimit janë të detyrueshme dhe përbëjnë pjesë integrale të vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime apo në punimet me shkrim ndalohen rreptësisht dhe trajtohen si shkelje serioze akademike. Në raste të tilla, studenti i nënshtrohet masave disiplinore sipas rregulloreve në fuqi të Universitetit të Prishtinës.